

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22 MAJ 2003

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 22. 05. 2003. GOD.

MAJ - 2003



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plehrat (2003/8)
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente zyrtare (2003/11)
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullatës, ekonomive familjare dhe të banesave (2003/12)
5. Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar „Kthimi” për emërimin e disa anëtarëve në Komisionet e Kuvendit
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emrimin e gjykatësve dhe prokurorëve
7. Parashtrimi i pyetjeve
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 29 Maj 2003
 - 8.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rrugët
 - 8.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë (2003/13)
 - 8.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrimit të të drejtave në pronësinë e paluajtshme (2003/14)

Vrejtje : Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrësia të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице
2. Друго разматрање Нацрта закона о вештачким љубривима (2003/8)
3. Прво разматрање Нацрта закона о приступу службеној документацији (2003/11)
4. Прво разматрање Нацрта закона о попису становништва, породичних Економија и станова (2003/12)
5. Разматрање предлога Парламентарне групе „Повратак,, о именовану неколико чланова у Комисијама Скупштине
6. Разматрање препоруке Судског и Тужилачког Веча о именовану Судија и Тужиоца
7. Постављање питања
8. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 29 маја 2003
 - 8.1 Друго разматрање Нацрта закона о путевима
 - 8.2 Прво разматрање Нацрта закона о јавним набавкама на Косово (2003/13)
 - 8.3 Прво разматрање Нацрта закона о изменама и допунама Закона о оснивању регистра права на некретнине (2003/14)

Опомена : *Питања упучена Влади за усмене одговоре*

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се оћекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes of previous meeting
2. Second reading of the Draft Law on the Fertilizers (2003/8)
3. First reading of the Draft Law on accessing the official documents (2003/11)
4. First reading of the Draft Law on the registration of the population, family Properties and housing (2003/12)
5. Review on the proposal of the Parliamentary Group „Return” concerned on the nomination of some of its members to the Committees of the Assembly
6. Review of the recommendation from the Judicial and Attorney ship Council of Kosovo concerned on the nomination of the Judges and Prosecutors
7. Questions
8. Proposal of agenda for the plenary session of 29 May 2003
 - 8.1 Second reading of the Draft Law on the Roads
 - 8.2 First reading of the Draft Law on the Public Procurement in Kosovo (2003/13)
 - 8.3 First reading of the Draft Law on the Changes and Fulfillments of the Law on Establishment of the Register on Immovable Property (2003/14)

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 22 MAJ 2003

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES, OLIVER IVANOVIQ, ANËTAR I
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

Seanca filloi punën në orën 10,15

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare. Iu dëshiroj mirëseardhje edhe ministrave të Qeverisë së Kosovës dhe sukses në punë të përbashkët.

Rendi i ditës është miratuar në Seancën e kaluar dhe pikë e parë është: **Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.**

Ne kemi bërë praktikë, ata që kanë vërejtje, le ta bëjnë me shkrim, por nëse ndokush sheh të arsyeshme, mund ta parashtrojë edhe gojarisht.

Ju falemnderit. Pasi që s'ka vërejtje, konsideroj se Procesverbali u miratua. Vazhdojmë punën.

Pika e dytë e rendit të ditës është: **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plehërat.**

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për plehërat ka bazueshmëri në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka konstatuar se Projektligji për plehërat nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, konstatoi se ky Projektligj nuk ka implikime buxhetore dhe financiare.

Dhe, çdo amendament i propozuar më poshtë, reflekton qëndrimin e Komisionit funksional të përkrahur nga komisionet kryesore.

Prandaj, kalojmë menjëherë në miratimin e amendamenteve.

Amendamenti 1, Komisioni funksional.

Komisionet tjera, a kanë ndonjë koment apo e përkrahin?

Atëherë, kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 2, Komisioni funksional.

Komisionet tjera, a kanë koment, vërejtje, sygjerime apo e përkrahin?

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon kush nga votimi? Askush.

Amendamenti miratohet.

Amendamenti 3, Komisioni funksional.

Besoj se është i përkrahur nga të gjitha komisionet, sepse u tha në parim më lartë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 4, Komisioni funksional, i përkrahur nga të tjerat.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 5, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni funksional, në përkrahje të komisioneve tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 7, Komisioni funksional, me përkrahje të komisioneve tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni funksional, i përkrahur nga të tjerat.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, i përkrahur nga të tjerat.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Nojkiq, as nuk je për, as kundër, as nuk po abstenon!?

RANĐEL NOJKIĆ:

Tako je, gospodine predjedavajući. Dobro ste primetili da nisam glasao ni za, ni protiv, ni uzdržan. Znaete li zbog čega? Zato što se krše ovde prava poslanika. Juče sam podneo amandmane, uredno, Sekretarijatu na Zakon o putevima i danas su mi se oni vratili. To se isto desilo i prošli put. I, na koji način vi mene motivišete ovde da ja učestvujem u radu Skupštine i u donošenju zakona kada kršite moja poslanička prava i kada mi ne dozvoljavate da dostavljam amandmane na regularan način, onako kako je predviđeno Poslovníkom i Ustavnim okvirima?

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë, as nuk i kthej amendamentet, as nuk i pranoj. Do të thotë, sigurisht ka qenë adresa e gabuar dhe nuk ka arsyetim tjetër. Por, duhet të analizohet kjo dhe jam plotësisht dakord dhe të mos ngjajë kështu: nëse është adresa e saktë? Ju falemnderit.

Amendamenti 13, Komisioni funksional, i përkrahur nga të tjerët.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 14, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 15, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 16, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Amendamenti i fundit 18, Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Miratohet amendamenti.

Tani duhet t'a votojmë në tërësi Ligjin e amendamentuar. Të pranishëm janë 85 deputetë.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Asnjë votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Konstatohet se u miratua Ligji me amendamentet e paraqitura në tërësi.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For.....Të gjithë – Svi – All...
 - Kundër – Protiv – Against.....00
 - Abstenuan – Uzdrzanih – Abstained.....00
-

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qasje në dokumente zyrtare.**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 6 maj 2003 dhe janë përmbushur kushtet për ta shqyrtuar dhe miratuar në parim.

Debati i sotëm do të shërbejë për qëllime të përgjithshme e parimore dhe sot nuk lejohen propozime të amendamenteve.

Ftohet ministri i shërbimeve publike, zoti Jakup Krasniqi ta paraqesë arsyeshmërinë e Projektligjit.

JAKUP KRASNIQI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Sot po paraqes Projektligjin për qasjen në dokumentet zyrtare para Kuvendit të Kosovës.

Me iniciativën e Zyrës së Kryeminsitrit, Qeveria e Kosovës, ka përgatitur Projektligjin për qasje në dokumente zyrtare dhe këtë e ka aprovuar me datën 8 prill 2003.

Në hartimin e Projektligjit kanë marrë pjesë, përveç pjesëtarëve të Zyrës së Kryeministrit dhe të Ministrisë së Shërbimeve Publike, edhe përfaqësues të organizatave joqeveritare kosovare, siç është, ndër të tjera, IREKS, të Organizatës Amerikane, Instituti Nacional Demokratik dhe po ashtu ekspertët ligjor të ekipit të Agjencionit Evropian për Rindërtim, të vendosur në Zyrën e Kryeministrit.

Projektligji i paraqitur, është një hap tejet i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të një administrate kosovare moderne, transparente dhe përgjegjëse para qytetarëve të Kosovës. Dispozitat kushtetuese na obligojnë që të rrespektojmë parimin e sundimit të ligjit, të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe parimet demokratike. Më tej, jemi të obliguar që ta harmonizojmë legjislacionin e Kosovës me standardet dhe të arriturat evropiane, me theks të veçantë në lëmin e së drejtës dhe të administrimit publik që të jetë sa më profesional dhe më i përgjegjshëm.

Duke patur parasysh këto objektiva dhe përcaktimet ligjore, Projektligji për qasje në dokumentat zyrtare, ka për qëllim ngritjen e nivelit të qeverisjes së mirë, të transparencës dhe të përgjegjësisë së organeve publike para qytetarëve të Kosovës, duke siguruar qasje të papenguar në dokumentet zyrtare. Kjo politikë e së drejtës së hapur do të rezultojë në ngritjen e ndjenjes së përgjegjësisë brenda organeve publike dhe si e tillë do të jetë mjet i rëndësishëm për luftimin dhe zhdukjen e zhvillimeve dhe dukurive negative, ndër të cilat korrupsioni zë vendin e parë.

Në sistematikën legislative, ky Projektligj, zë vendin e vet si pjesë e politikës dhe strategjisë së përgjithshme të Qeverisë së Kosovës për luftimin e korrupsionit dhe krijimin e një administrate moderne, transparente dhe të përgjegjshme, të cilën qytetarët e shohin si administratë në shërbim të tyre.

Politika e derës së hapur ndaj qytetarëve, e cila reflektohet në Projektligjin për qasjen në dokumente zyrtare, është një vijë e njëjtë me politikën e derës së hapur të Unionit Evropian.

Legjislacioni, i cili është marrë për bazë gjatë hartimit të Projektligjit

Mund të thuhet padyshim se ky Projektligj plotësisht inkooporon të drejtën dhe standardet evropiane dhe me këtë ngritë administratën e Kosovës në nivel tejet modern.

Nga aspekti juridik, Projektligji përmban përkufizime të qarta se çka nënkupton termi dokument zyrtar dhe cili është fushëveprimi i ligjit. Të drejtat e qytetarëve, siç janë paraparë me këtë Projektligj, gëzojnë mbrojtje ligjore, efektive si në kuadër të procedurës administrative, ashtu edhe në kuadër të procedurës gjyqësore dhe asaj të Ombduspersonit në Kosovë.

Projektligji është i hartuar në pajtim të plotë me Kornizën kushtetuese, duke theksuar pajtueshmërinë e Projektligjit me konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të zbatueshme në Kosovë, si dhe të drejtat e komuniteteve të përcaktuara me Kornizën kushtetuese.

Projektligji në mënyrë eksplicite parasheh që pjesëtarët e komuniteteve kanë mundësinë që të dorëzojnë parashtrirat e tyre dhe të marrin dokumentet e kërkuara në gjuhën e tyre gjegjëse.

Në anën tjetër, Projektligji, gjithashtu, merr parasysh dhe mbronë interesat vitale të institucioneve publike të Kosovës, të cilat kufizojnë të drejtën e qytetarit për qasje

në dokumentat zyrtare, kur është fjala për çështjet të cilat i përkasin sigurisë publike, çështjet e mbrojtjes dhe atyre ushtarake, marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe politikave financiare, monetare dhe ekonomike.

Më tej, Qeveria merr përsipër detyrimin që të rregullojë kushtet dhe procedurat për klasifikimin e dokumentave të ndjeshme, qasje në të cilat do të kufizohet për qytetarët, dhe aty interesat vitale publike kanë përparësi.

Me këtë Projektligj të paraqitur, gjendet balanci i duhur në mes drejtës së qytetarit për qasje në dokumentat zyrtare dhe mbrojtjes së interesave publike, duke marrë si shembull dhe udhërrëfyes legjislacionin dhe praktikën e Unionit Evropian.

Përfundimisht, mund të thuhet se me miratimin e këtij Projektligji nga Kuvendi i Kosovës, Kosova jo vetëm se do të fitojë një instrument të fuqishëm në luftimin e korrupsionit, por do të bëhet shembull në rajon për gatishmërinë e shprehur për krimimin e një administrate moderne, transparente dhe të përgjegjshme për qytetarët e saj. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti ministër, ju falemnderit.

Tani hap debatin për diskutim në parim.

Urdhëroni, zoti Çelaj.

LIRAK ÇELAJ:

Zoti kryetar, të nderuar kolegë, zotëri ministra,

Flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe meqë ky Projektligj ishte i shkurtër, do të përpiqem edhe unë të jam i shkurtër.

Mendoj se Projektligji për qasje në dokumente zyrtare është mjaft sublim dhe korrekt. Në të janë paraparë të gjitha format se kur një dokument mund të jetë i qasshëm dhe kur jo; si duhet proceduar pala e tretë, domethënë çdo person fizik, juridik, si dhe çdo intetitet jashtë institucionit në fjalë dhe si ajo që ofron këtë shërbim, madje edhe afatet dhe format se si duhet komunikuar me institucionet përkatëse. Afatizimi i trajtimit të kërkesave të palëve të treta, është për t'u

lavdëruar ngase kjo do të eliminojë byrokratizimin dhe do të mundësojë që qytetarët të kenë qasje sa më të shpejtë dhe efikase.

Ajo, që për mua është për t'u diskutuar, është neni 4.7, ku thuhet, ndër të tjera, se përjashtimet mund të vlejné më së shumti deri në 30 vjet prej kohës së krijimit të dokumentit. Mendoj se ky afat duhet të jetë më i gjatë dhe mundësisht të shikohet se si është përvoja e shteteve tjera demokratike për këtë çështje.

Dhe, krejt në fund, nuk jam i sigurt se, afatet që janë caktuar me dispozitën kalimtare, në nenin 17.1 dhe 17.2, mund të realizohen ashtu siç janë paraparë. Prandaj, propozoj që këto të shqyrtohen edhe një herë.

Edhe një herë po përsëris: Projektligji është në përgjithësi i mirë dhe ndoshta do të mund të jetë shembull për projektligjet tjera si nga aspekti përmbajtësor, ashtu edhe ai gjuhësor.

Ne, Grupi Parlamentar i PDK, përkrahim këtë ligji në parim dhe do të votojmë pro këtij ligji. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Blerim Baruti, le të bëhet gati Lilana Keniq.

BLERIM BARUTI:

I nderuar kryetar, të nderuar ministra prezent, të rrespektuar deputetë,

Ju lutem, më lejoni që në kuadër të shqyrtimit të parë të Projektligjit për qasje në dokumentet zyrtare, t'i paraqes disa vështrime të mia.

Me këtë ligj, korniza ligjvënëse kosovare po begatohet edhe më tej. Në kuadër të ligjit në shqyrtim do të mundësohet e drejta e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare kosovare, duke mundësuar që institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë ta ngrisin nivelin e cilësisë në qeverisje sa më të mirë, duke mundësuar transparencë, efektivitet, përgjegjësi dhe llogaridhënie para qytetarëve dhe organeve të saja dhe gjithnjë duke luftuar zhvillimet negative të shoqërisë. Në ligj janë paraparë edhe rastet e arsyetuara për përjashtime dhe përkufizime në qasje. Trajtimi i kërkesave me mekanizëm kohor të afatizuar, kërkesat do të parashtrihen në forma të shkurara apo edhe elektronike në njërën nga gjuhët zyrtare dhe të komuniteteve në Kosovë dhe me saktësi të mjaftueshme, ashtu që institucioni të mund ta identifikojë dokumentin.

Gjatë leximit të këtij Projekligji, kuptova se në përpilimin e tij, kontribut dhe angazhim të çmuar kanë dhënë edhe këshilltarët ndërkombëtar të Zyrës së Kryeministrit si dhe Organizata Amerikane – Instituti Demokratik Kombëtar NDI, të cilët, me këtë rast do t'i falënderoja që po na krijojnë mundësinë dhe ndihmesën në bartjen e përvojave të tyre demokratike në ndërtimin e krijimit të një legjislacioni kosovar.

Ky ligj do të hapë shtegun edhe për nxjerjen e akteve nënligjore në mënyrë që më tej ky ligj të plotësohet dhe të begatohet.

Krejt për fund, më lejoni që përgjithësisht t'i përgëzoj hartuesit e këtij ligji. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

~~Ju falemnderit, Lilana Kenic, Ie të përgatitet Zylfije Hundozi~~

LILJANA KENIĆ:

Poštovani predsedniče Skupštine, poštovane kolege poslanici,

Zahvaljujući NDI već smo bili u prilici da se upoznamo sa sličnim zakonima na konferenciji, gde su nam predočeni zakoni više zemalja u oblasti slobodnog pristupa dokumentaciji. I, nema sumnje, da je smisao i cilj ovih zakona da promovišu transparentnost rada privremenih institucija, adekvatan uvid javnosti u radu institucija, veću odgovornost i efikasnost istih u cilju zadobijanja poverenja javnosti. Upoznali smo se sa osnovnim smernicama i načelima koje je pripremila i usvojila Komisija ministara članica zemalja Saveta Evrope o pristupu službenoj dokumentaciji.

Obzirom da je u izradi Nacrta ovog zakona bio uključen i NDI, zakon je suštinski obuhvatio sve date smernice i principe.

Ali, ono što me iznenađuje, jer je NDI bio učesnik u izradi zakona, je to da se ovim zakonom, tačnije članom 4. predviđaju i nadležnosti institucija po pitanjima koji su u isključivoj nadležnosti SPGS. Pominju se: javna bezbednost, odbrana i vojna pitanja, međunarodni odnosi, monetarna politika.

Po Ustavnom okviru, ova pitanja, ne spadaju pod odgovornost privremenih institucija, pa je neprihvatljivo da navedena pitanja budu uvrštena u ovaj zakon.

Naglašavam da su ova pitanja, pa time i dokumenta, u nadležnosti SPGS – Poglavlje 8.2. tačka c) i d) i Poglavlje 8.1 tačka d) a delom su nadležnosti i KFOR-a.

U članu 8., predviđen je postupak u slučaju dokumenata osetljive prirode, koje bi, po mom mišljenju, mogle da egzistiraju uz prethodnu saglasnost SPGS.

Dalje, u članu 3. tačka 1. i 2. – ne znam zašto se vrše podvajanje između stalnih stanovnika kosmeta i onih koji to nisu.

Poredeći sa ostalim zakonima, mišljenja sam da je princip..., da su službena dokumenta dostupna javnosti. Dakle, svim fizičkim i pravnim licima, bez obzira na stalni ili privremeni boravak uz predviđena ograničenja podjednaka za sva lica.

Kao što sam već rekla, zakon jeste važan, ali se bojim da će prednosti ovog zakona koristiti samo Albanskoj zajednici, a za ostale, posebno za Srpsku zajednicu, biće to samo deklarativan akt. Naime, za stvarnu primenu ovog zakona potrebno je ispuniti preduslove koji su garantovani Evropskom konvencijom za zaštitu ljudskih prava i osnovnih sloboda i njenih protokola a osnovni preduslov je pravo na slobodu i bezbednost ličnosti predviđenih članom 5. navedene Konvencije i Protokolom broj 4. koji garantuje slobodu kretanja.

Naprosto, nakon pročitanoog zakona, nameće suštinsko pitanje: Kako će neko iz Srpske zajednice zahtevati uvid u dokumenta neke institucije ako ne može da dođe do te institucije, jer mu nije obezbeđeno osnovno pravo – pravo na slobodu kretanja.

Zbog toga, mišljenja sam da zakon nije primeren postojećim okolnostima i dešavanjima na Kosovu i metohiji i da je neophodno da se njegova primena odloži dok se ne steknu jednaki uslovi za pristup svih građana službenoj dokumentaciji.

Hvala!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zylfije Hundozi, le të përgatitet Muhamet Kelmendi.

ZYLFIJE HUNDOZI:

Zoti kryetar, deputetë të nderuar,

Projekligji për qasje në dokumente zyrtare të institucioneve të përkohshme të

vetëqeverisjes është i përgatitur mirë, është i shkruar qartë, gjë që na bën lehtë t'i kuptojmë synimet e tij dhe mënyrën se si do të realizohet.

Shpresoj se, me zbatimin e këtij ligji, do të sigurohet qeverisje e mirë dhe transparente e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, duke u krijuar kushtet për një përgjegjësi më të madhe ndaj popullatës së gjerë.

Me nenin 4, precizohet se në cilat dokumente qytetarët e Kosovës nuk do të kenë qasje, gjegjësisht publikimi i të cilave do t'i cenojë interesat vitale të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes pos nëse ekziston interesi i përgjithshëm për publikimin e këtyre dokumenteve.

Ky ligj, në realitet, pasqyron shumëmirë jetën reale në Kosovë. Trajton vetëm një pjesë të saj, gjegjësisht tregon mundësinë e qasjes vetëm në dokumente zyrtare të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, të cilat mirren me trajtimin e vetëm një pjesë të jetës në Kosovë, ndërsa me pjesën tjetër mirret UNMIK-u, e në këtë ligj thuhet se – qytetarët e Kosovës nuk do të kenë qasje në asnjë dokument zyrtar të UNMIK-ut - dhe as që përmendet ndonjë afat kohor pas të cilit kjo gjë do të jetë e mundshme.

Pra, edhe me këtë ligj, na jipet porosia se demokracia në Kosovë është e pjesërishme dhe se lirisht mund të aplikohet thënia popullore: "Se ligji është rrjetë e marimangës, në të cilën bien insektet dhe shtazët e vogla. Të mëdhatë kalojnë nëpër të duke e shkelur".

Deklaroj se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në parim, përkrahë këtë ligj, e pastaj, në komisionet përkatëse, do të sygjerojmë që të bëhet zgjerimi i tij me amendamente ose ndonjë aneks me të cilin do të mirrej në konsiderim afati kohor për qasje në dokumentet e UNMIK-ut, të cilat janë pjesë e jetës dhe realitetit në Kosovë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Muhamet Kelmendi e ka fjalën.

MUHAMET KELMENDI:

Zonja dhe zotërinj, i nderuari kryetar,

Fusha, të cilën e rregullon Projekligji, është jashtëzakonisht e madhe. Qytetarët e Kosovës kanë kaluar në të kaluarën nëpër një situatë jashtëzakonisht të rëndë, ku,

pothuaj askush nuk ka pasur qasje në dokumentet me çka iu është bërë padrejtësi jashtëzakonisht e madhe, duke filluar nga administrata, në polici, në organe të judikaturës, në gjykata e kështu me radhë. Prandaj, është një rëndësi jashtëzakonisht e madhe që ne kemi Projektligjin në dorë dhe e shqyrtojmë sot dhe me të cilin jipet mundësia dhe e drejta që çdo qytetar t'i shikojë ato dokumente mbi bazën e të cilit është vendosur e drejta e tij.

Natyrisht, mendoj se në këtë Projektligj, duhet të shtrihet fushëveprimtaria edhe më e thellë, të shkojmë edhe te dokumentet zyrtare të cilat kanë qenë në fuqi këtu para se të çlirohet Kosova. Fjala është për dosje të mëdha, të cilat kanë qenë anëekënd Kosovës. Fjala është për aktgjykime të mëdha. Fjala është për dokumente të ndryshme që kanë nxjerrë organet serbo-jugosllave gjatë historisë këtu. Duhet të jipet mundësia pra për një qasje të tillë dhe qytetarët e Kosovës të kenë mundësi të futen edhe më thell, jo vetëm në dokumentat që lëshohen aktualisht por edhe në dokumentat të cilët kanë qenë gjatë historisë dhe që është vendosur mbi ta.

Çështja e dytë, për të cilën unë mendoj se hartuesi duhet të ketë kujdesje jashtëzakonisht të madhe, është fjala e interesit publik. Ne mjaft mirë kemi parë në Projektligj se janë të përcaktuara fushat ku ne nuk kemi mundësi fare t'i qasemi dokumenteve zyrtare. Mirëpo, të njëjtën kohë, përcaktohet edhe fjala e interesit publik ku iu jipet mundësi organeve të cilat vendosin për një të drejtë të një qytetari që në momente të caktuara të nxjerrin vendimin duke u mbështetur vetëm në këtë fjalë dhe mos të lejojnë qasjen në dokumentet e tilla.

Mendoj se hartuesi i Projektligjit të tillë, duhet në mënyrë më të përkufizuar dhe në mënyrë më të qartë të përcaktojë se çka kuptohet me fjalën – interesi publik. Sepse, në qoftë se lejohet interpretimi i personit zyrtar në një administratë të përcaktojë... ai, duke u mbështetur në interesin publik në çdo moment dhe në çdo kohë - mund të përjashtojë të drejtën e qasjes në një dokument të tillë.

Dhe në fund, më lejoni që ta them një ide që mendoj është shumë me rëndësi. Ne rregullojmë një çështje e cila ka të bëjë me çështjen e dokumenteve zyrtare, por nuk iu kemi qasur pikërisht problemit të zgjidhjes dhe të mundësisë së rregullimit juridik të dhënies së dokumenteve zyrtare. Fjala është këtu për dokumentet, në të cilat organet e Kosovës, nuk kanë kompetenca në lejen e njoftimit, pasaporta e që, - qytetarët e Kosovës kanë më së shumti të drejtë, duke u mbështetur në interesat e tyre dhe në qindra-mijëra qytetarë të Kosovës të cilët janë të vendosur anëekënd botës, e të cilët nuk kanë mundësi fare që të vijnë në Kosovë, pikërisht për mosrregullimin juridik të kësaj fushe.

Prandaj, kërkoj që hartuesi i këtij dokumenti, i këtij Projektligji, më me ngulm dhe në mënyrë intensive të punojë në drejtim të rregullimit dhe nxjerrjes së një

projekligji dhe që do t'i jipet Kuvendit mundësia e nxjerrjes së një ligji ku do të rregullohet kjo fushë shumë e rëndësishme. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI:

Zoti kryetar, deputetë të çmuar,

Ligji, për të cilin po bisedojmë, ka një rëndësi të veçantë, sepse, u tha edhe nga parafolësit tjerë, rregullon një materie shpeshherë të ndieshme, shumë të diskutuar brenda institucioneve por edhe brenda njerëzve të interesuar që të kenë një qasje në dokumentet që janë të rëndësishme, të rëndësisë së veçantë për institucionet por edhe për komunikimin publik; kështu që krijohet definitivisht ai komunikimi i famshëm në mes autoritetit, burimit të informatës dhe atij që do ta marrë informatën. Në përgjithësi, ekziston një strukturim i mirë i kërkesave dhe i ligjit si tërësi, ndonëse aty-këtu janë disa elemente që nuk janë përcaktuar dhe është mirë që qysh sot, në këtë lexim, të kemi një qëndrim rreth tyre.

Neni 4 dhe 8 natyrisht përcakton atë që quhet - e ndieshme. Mirëpo, këto probleme do të rregullohen më vonë sepse gama - fusha është shumë e gjerë e problemeve që quhen të ndieshme dhe të rëndësisë së veçantë dhe ato, natyrisht, do të rregullohen me rregullore, nënligje ose elemente tjera përcaktuese.

Në nenin 7. Unë mendoj se qysh tash duhet të mendohet se e mërtimi i tij dhe: trajtimi i kërkesave konfirmuese, shqip s' thotë bash kurgjë hiq. Ajo, në të vërtetë është trajtimi i kërkesave të arsyeshme. Këtu, po thuhet, se po hartohen ligjet shqip!? Por s'po më bindin fare, sepse kalket janë aq qesharake saqë dihet shumëmirë dhe kanë probleme njerëzit tanë t'i përkthejnë kalket e huaja për fjalët që kanë një trashigimi përdorimi publik edhe nga 40 vjet te ne. Mos u tutni, e arsyeshme është, shumë më e qartë se sa konfirmuese.

Tjetra. Te neni 4.7, ku përmendet – gjatësia e dokumenteve të cilët nuk do të kishin qasje publike, thuhet deri në 30 vjet. Është mirë që të precizohet saktë – sa. Sepse, janë dokumente me rëndësi të veçantë dhe çdo shtet a shoqëri ka një përcaktim shumë të saktë kush janë këto dokumente, cilat dhe saktë sa mbeten të mbyllura ose të mos jenë në dorë të interesentëve përtej institucioneve.

Pastaj. Te dispozitat kalimtare. Neni 17.1 dhe 17.2, paragjykon kur fillon ky ligj e kur s'fillon, pa e ditur kur do të aprovohet. Unë kujtoj se të dyja këto nene duhet të merren si paragjykuese, domethënë nuk mund të votohen si të tilla sepse përcaktohet çdo gjë dhe nga ajo kur do të miratohet ky ligj.

Dhe, në fund, kur flasim, pa pasur qëllim që t'i them askujt kurgjë dhe pa të keq... Por në këtë foltore, metaforat janë shumë të rrezikshme. U pa nga një parafolës imi, kur u quajt ligji – “në rrjetë marimange”. Keni kujdes, se në të folurit politik “rrjeta marimangë” më shumë i shkon diktaturës sesa demokracisë.

Unë përkrah ligjin në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Hamiti. Dëgjuam të gjithë ata që janë përgatitur për të debatuar në parim.

ZYLFIJE HUNDOZI:

“Rrjetën e marimangës”, bash për atë qëllim e pata. Ajo çka po simbolizon... Nëse ne s'kemi qasje në dokumente të cilat i përkasin jetës sonë së përditshme, realitetit tonë, atëherë çfarë është ajo – diktaturë!? Atë qëllim edhe e pata.

SABRI HAMITI:

Mua më vjen keq, unë e thash pa të keq, por meqë po thuhet fjala tepër publikisht dhe në institucion të lartë, unë vetëm tërhoqa vërejtjen: Metaforat janë të rrezikshme në formulimet politike. Unë vetë jam prodhues i metaforave dhe e di rrezikun e tyre në tubime... Dhe, arsyetimi i dytë - veç e përforcon atë të parën, prapë, a? Kështu që, është mirë, të ruhem nga metaforat në jetën politike. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Megjithatë, unë e mbështes autorin. Ju përkrah dhe jam në anën tuaj. S'ka nevojë më të paraqiteni. Ju falemnderit të gjithëve.

Ju ftoj që ta mbështesim në parim Projektligjin e debatuar.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Le të numërohen votat, ju lutem. 9 Kundër. Ju falemnderit.

A abstenon ndokush? 3 abstenime.

Konstatohet se Ligji është aprovuar në parim, me 9 vota kundër dhe 3 abstenime. Ju falemnderit.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For:Shumica – Vecina – Majority...
 - Kundër – Protiv – Against 09
 - Abstenuan – Uzdrzanih – Abstained...03...
-

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e popullatës, ekonomive familjare dhe të banesave.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 6 maj 2003 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Prandaj, ftoj ministrin e shërbimeve publike, zotin Jakup Krasniqi, që ta paraqesë fjalën hyrëse.

JAKUP KRASNIQI:

Para se të filloj ta lexoj fjalën, dua të them se ky ligj është njëri prej ligjeve të para që Qeveria e Kosovës ka përcjellur për në Parlament dhe ai ka arritur në Parlament vetëm pas përcjelljes së tretë.

Në bazë të Kornizës kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19, Kreu 5, pika 5.1, të datës 15 2001 dhe në bazë

të udhëzimit administrativ të Zyrës së Kryeministrit 1/2002, mbi procedurën e përpilimit dhe parashtrimit të ligjeve, Ministria e Shërbimeve Publike hartoi Projekligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të Kosovës.

Arsyet për nxjerrjen e ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave të Kosovës, janë të shumta dhe të llojllojshme. Ky ligj do të ofrojë zgjidhje ligjore sistemore për zbatimin e regjistrimit të popullsisë dhe do ta autorizojë Entin e Statistikave të Kosovës të organizojë regjistrimin më 1 prill të vitit 2004.

Struktura demografike dhe karakteristikat kryesore sociale-ekonomike të popullsisë që përmban ligji:

- numrin e përgjithshëm dhe shpërndarjen territoriale të popullsisë së Kosovës;
- numrin dhe shpërndarjen territoriale të popullsisë së Kosovës;
- numrin dhe shpërndarjen hapësinore dhe strukturën e vendbanimeve dhe të ndërtesave të shfrytëzuara me qëllim banimi dhe dedikime tjera;
- kushtet e banimit dhe standardet jetësore të popullsisë.

Pra, qëllimi i regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovës, është sigurimi i të dhënave përmes vrojtimit të plotë mbi banesat dhe karakteristikat socio-ekonomike dhe demografike të popullsisë dhe analizimi e shpërndarja e të dhënave të shfrytëzuesve të interesuar në institucionet shtetërore dhe atyre publike e private.

2. Përmes këtij ligji do të bëhet regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, në mënyrë valide, sepse regjistrimi i vitit 1991, i organizuar nga enti statistikor i jugosllavisë ishte specifik, duke patur parasysh se popullsia shqiptare e Kosovës refuzoi regjistrimin nga ana e pushtetit ilegjitim.

Në kapitullin e parë, përshkruhen dispozitat e përgjithshme; qëllimi i organizimit të regjistrimit; objekti i ligjit; autoriteti i regjistrimit; data; periudha e evidentimit; subjekti, si dhe rezultatet e regjistrimit me regjistra statistikor.

Kapituli i dytë, përmban kompetencat dhe raportet e organeve kompetente përgjegjëse për regjistrim, përkatësisht Komisioni qendror i regjistrimit dhe organet tjera qendrore dhe komunale.

Në kapitullin e tretë, përcaktohet obligimi i Qeverisë, i Minsitrisë së Shërbimeve Publike, i Ministrisë së Financave dhe i Entit Statistikor të Kosovës, të bëjnë përgatitjet për regjistrimin dhe t'ia dërgojnë Kuvendit të Kosovës për miratim.

Në kapitullin e katërtë, përcaktohen procedurat e regjistrimit, publiciteti i mediave gjatë fushatës si dhe obligimi i të gjitha institucioneve që të jenë në shërbim për realizimin e regjistrimit.

Prandaj, dëshiroj që ky Projektligj të miratohet në këtë Kuvend. Natyrisht, duke dëshiruar që, nëse ka nevojë, të bëhen plotësime të nevojshme. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, ministër.

Hap debatin në parim.

Për fjalë, është paraqitur zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Të falemnderit zoti kryetar, kolegë të çmuar,

E shoh këtë ligj të një rëndësie të veçantë për zhvillimet shoqërore që do të ndodhin në Kosovë dhe për nevojat e pakapërcyeshme rreth lëvizjeve shoqërore në vendin tonë.

Unë, megjithatë, kam një kërkesë që është themelore dhe që e konsideroj të rëndësishme të veçantë, po aq sa është i rëndësishëm të veçantë vetë nxjerrja e ligjit.

Mua më duket se ligji është restriktiv paarsyeshëm, dhe unë do të përshkruaj objektin e tij duke lexuar nenin 3 a) ku thotë: "Popullsia rezidente duhet të nënkuptojë popullsinë e përbërë nga individët të cilët në ditën e evidentimit ndodhin në territorin e Kosovës si dhe ata që përkohësisht mungojnë më pak se një vit" dhe neni 7 pika 2 – "Regjistrimi përfshin popullsinë rezidente dhe të gjitha ndërtesat e tjera". Siç e shihni, të dy këto nene, totalisht lënë jashtë të gjithë banorët e përkohshëm të Kosovës, që jetojnë jashtë, kryesisht në Evropën Perëndimore, që janë rreth 400 mijë. Ju po shihni, unë them rreth 400 mijë, se s'ka

njeri të gjallë që e din sa janë, pikërisht sepse s'janë regjistruar. Ju e dini, një provë viteve 90-ta institucionet e organizuara të Kosovës që të bëjnë një regjistrim i cili është ndalë diku në mes të rrugës dhe nuk është kryer totalisht, domethënë edhe nuk është shpallë publikisht.

Ky është një problem shumë-shumë i madh, esencial për Kosovën, sepse kemi një masë të madhe të popullsisë që jeton përkohësisht jashtë, punon ose s'punon jashtë dhe nëse ne i lëmë jashtë regjistrimit, ne do t'i lëmë jashtë mënyrës së identifikimit, jashtë përkatësisë, jashtë funksionimit të tyre me vendin e tyre që është një situatë shumë-shumë e rrezikshme, do të thosha unë.

Prandaj, unë propozoj që – ose brenda këtij ligji, duke filluar nga titulli – të thuhet: Regjistrimi i popullsisë që banon me banim të përhershëm në Kosovë dhe i popullsisë që banon përkohësisht jashtë dhe me disa nene të rregullohet kjo materie këtu, ose, nëse jo, atëherë të premtohet këtu se do të hartohet një ligj i veçantë për atë regjistrim atje.

Dhe, gjithnjë lidhur me këtë, unë po ndalem te dy terma që janë terma tash themelore dhe çelës për materien e këtij ligji dhe një materie që mungon nga ky ligj. Thuhet “rezident”. Ju lutem shumë, shqip s'thotë kurgjë – rezident dhe jorezident. Këto janë terma të marrura. Shqip është shumë e qartë – banor i përhershëm i Kosovës dhe banor i përkohshëm jashtë. Jorezident i bie, shqip me përkthyer drejtpërdrejt si: i pashtëpi. Unë po them që njerëzit e Kosovës që janë jashtë nuk mund t'i lëmë të pakujdesje, të paatdhe dhe të paidentitet qytetarë e shtetërorë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Ismajl Kurteshi, le të bëhet gati Dragisha Kërstoviq.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, zoti ministër, të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, hartimin dhe sidomos aprovimin e këtij Projektligji e konsideron një çështje të rëndësishme së veçantë, pasi që hartimi dhe aprovimi i këtij Projektligji i paraprinë regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave të Kosovës, gjë që është shumë e nevojshme

pasi që një regjistrim i mirëfillt, profesional, në kushte normale nuk ka ndodhur në Kosovë pothuaj asnjëherë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, angazhohet që të sigurohet një ligj i depolitizuar, që i plotëson standardet profesionale, përmes të cilit do të sigurohet një regjistrim profesional, që do ta pasqyrojë realitetin kosovar e do të mundësojë marrjen e vendimeve të drejta në të gjitha lëmitë, pasi që funksioni primar i statistikës është pasqyrimi i realitetit, por edhe zgjidhje e problemeve të lidhura me regjistrimin.

Në Kosovë jetojnë mijëra qytetarë të shpërngulur para disa viteve nga Lugina e Preshevës, nga Maqedonia e nga vise të tjera dhe ata, edhe pse këtu paguajnë kontributet, këtu shkollohen, punojnë e jetojnë, këtu e kanë edhe pasurinë e tyre, ende nuk kanë mund të nxjerrin dokumente personale.

Me vështirësi të ngjashme po ballafaqohen edhe shumë punëtorë tanë në botën e jashtme të cilët janë të lidhur me Kosovën, e kanë pasurinë këtu dhe vazhdimisht ndihmojnë ose investojnë në Kosovë. Pra, edhe pse janë ngusht të lidhur me Kosovën, trajtohen si të huaj dhe detyrohen t'i përdorin dokumentet e huaj dhe nuk mund t'i shfrytëzojnë të drejtat që i shfrytëzojnë qytetarët tjerë të Kosovës.

Në anën tjetër, qytetarët e pandërgjegjshëm, të ndihmuar edhe nga matrapazë e shërbime të caktuara të administratave lokale, me dokumente të fallsifikuara e të nxjerra në Serbi, jo vetëm që sigurojnë dokumente personale por me dokumenta të tillë bëjnë edhe bartjen e pronës.

Ne mendojmë që, para se të fillojë regjistrimi, është e rëndësishme të përfundojë edhe emërtimi i rrugëve, lagjeve dhe vendbanimeve të Kosovës në mënyrë që qytetarët e Kosovës, pas regjistrimit, t'i kenë edhe adresat e tyre.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, vlerëson lartë punën profesionale dhe përkushtimin e Ministrisë në hartimin e këtij ligji dhe në parim përkrahë miratimin e tij. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dragisha Kërstoviq. Le të bëhet gati Fetije Këpuska.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, gospodine ministre, dame i gospodo poslanici,

Ja imam tri suštinske i načelne primedbe na Nacrt zakona koji je dat. I odmah, na početku da kažem, sa stanovišta Koalicije «Povratak» i sa stanovišta Srpske zajednice ovaj zakon, ovako kako je dat - je neprihvatljiv. Inače, ne sporim značaj jednog zakona o popisu stanovništva, domaćinstava i stanova na Kosovu. Kosovo treba da ima takav zakon, ali treba da ima drugačiji zakon nego kao što je dat u Nacrtu.

Prva moja primedba i primedba koju ponavljam mnogo puta je da ni ovom prilikom u izradi ni ovog zakona ni Zakona koji smo maločas imali na prvom čitanju, nisu učestvovali srpski eksperti. Dakle, ta praksa se ponavlja. Vlada se u to oglašuje i Vlada očigledno nema nameru da po ovim pitanjima angažuje bilo kojeg srpskog eksperta za učešće u izradi zakona koje Skupština usvaja.

Druga moja primedba će se odnositi na one odredbe na koje je ukazao gospodin Sabri Hamiti, ali, gospodin Sabri Hamiti, izražava zabrinutost za brojne hiljade onih koji su iz Albanske nacionalne zajednice ovog trenutka u inostranstvu, što jeste činjenica, a ja izražavam zabrinutost za brojne hiljade onih Srba koji su do 99. godine živeli na Kosovu i metohiji a koji sada žive van Kosova.

Zakon, u članu 3., pokušava da definiše, zapravo definiše rezidentno stanovništvo i kaže da se pod tim podrazumeva stanovništvo koje se sastoji od individua, koji su na dan potpisivanja prisutna na teritoriji Kosova kao i lica koja su privremeno odsutna u vremenskom trajanju manjem od godinu dana.

A u članu 7., u stavu 2. kaže: popisom se obuhvata rezidentno stanovništvo, dakle to koje je prisutno ili koje je odsutna manje od godinu dana i sve zgrade unutar teritorije Kosova koje se koriste za stanovanje, bez obzira da li su to pokretnine ili nekretnine. Ako zakon bude ovako usvojen, odnosno usvojen kako je dat u Nacrtu, onda će 230 hiljada Srba automatski biti eliminisano i to će biti zakon koji će, po svojoj suštini, biti diskriminacioni zakon u odnosu na Srpsku zajednicu i mi se, naravno, sa tim zakonom nećemo složiti, za njega nećemo glasati i primenićemo sve one mere koje, po Ustavnom okviru i po Poslovniku imamo, da sprečimo donošenje ovakvog zakona u Skupštini. Ovakvog!?

I treća, pravno-tehnička primedba, koja je istovremeno i suštinska. U članu 6. se reguliše datum popisa i vremenski period evidentiranja i kaže: momenat za popis stanovništva određen je na dan 31. marta 2004. godine u ponoć, u 24,00 časova.

Popisivanje treba izvršiti tokom aprila meseca 2004.godine, što će reći da je ovaj zakon zakon za takozvano jednokratnu upotrebu i da posle tog popisa koji će se izvršiti 31. marta 2004.godine zakon neće imati više važnost. Ja bih..., ja smatram da ovo pitanje, kada treba da se izvrši popis, treba da o tome odluči Vlada na osnovu zakona, na osnovu odredbe koju će sadržavati zakon. I, imam utisak da je prema tome zakon, ovaj zakon, ako ostane ovakav i ako se ovakav usvoji, a smatram da neće, Komisija će, nadam se, odraditi ozbiljno svoj posao, naročito Komisija za prave i interese zajednica koja će reagovati u slučajevima koje sam istakao. Ako ostane ovakav onda će to biti neki lex specialis – zakon za određeni slučaj.

I na kraju, gospodin ministar je u svom izlaganju za popis od 91. godine, rekao da ga radila nelegitimna država. Ovakva kvalifikacija je za Koaliciju «Povratak» neprihvatljiva zaista, jer ako je 91. godine vršen popis, onda zaista ne može biti nikakve reči o opisu preduzetom od strane nelegitimne države.

I, još jednom, na kraju, Koalicija «Povratak» ovakav Nacrt zakona ne može da prihvati u načelu. Hvala!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fetije Këpuska, le të bëhet gati Naim Maloku.

SABRI HAMITI:

Zotëriu, që foli pas meje, ma mori emrin n'gojë dhe u përpoq ta interpretojë bisedën që e thash unë. Njëri, këtu i Kryesisë, po thotë, domethënë, - e ka përkrahë atë. Nuk e ka apërkrahë por e ka interpretuar. Unë e di shumë mirë çka flas saktësisht. Kurrfarë përcaktimi nacional unë nuk kam dhënë, as shqiptar, as serb, as magjup, as egjiptas, as kurrfare. Unë kam thënë: – njerëzit që janë qytetarë të Kosovës dhe banojnë përkohësisht jashtë. Prandaj, unë e di çka them dhe pse e them. Interpretimi është paragjykes, sepse zotëria mendon se unë flas vetëm për shqiptarët, e ai e ka detyrë veç për serbët. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Fetije Këpska, le të bëhet gati Naim Maloku.

FETIJE KËPUSKA:

T'falemnderit, zoti kryetar, kolegë deputetë,

Ndonëse janë të shumta lëmitë dhe sektoret e jetës shoqërore, për të cilët ende nuk kemi miratuar rregullativën ligjore, megjithatë mendoj se ka arsye të shumta të shtrojmë në shqyrtim dhe sa më shpejt ta miratojmë ligjin për regjistrimin e popullsisë së Kosovës, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Ky ligj duhet të përcaktojë procedurat, afatet, t'i adresojë bartësit e punës e të aktiviteteve, strukturat, përgjegjësit dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet që të kryhet regjistrimi profesionalisht, me kohë dhe me saktësi në tërë Kosovën, natyrisht sipas kritereve dhe standardeve ndërkombëtare. Do të jetë ky, padyshim, një projekt shumë i rëndësishëm shoqëror. Si një projekt kompleks, ai ngërthen në vete edhe shumë aspekte të tjera, pos atij politik.

Regjistrimi i popullsisë së Kosovës shtrohet natyrshëm si një punë e ngutshme dhe e domosdoshme, pikësepari nga fakti se një regjistrim i tillë nuk është bërë – ka më shumë se 20 vite. Shkaqet përse ka ndodhur kështu, janë të njohura për të gjithë, prandaj edhe nuk do t'i prezentoj.

Siç dihet, regjistrimet e këtilla në vendet e botës, bëhen rregullisht së paku në çdo dhjetë vite. Ç'është e vërteta, deri tash, në bazë të metodave të ndryshme statistikore dhe demografike, janë prezentuar shënime aproksimative nga organizatat dhe institucionet e ndryshme për numrin e përafërt të popullsisë së Kosovës, por që nuk mund të jenë as të sakta e as zyrtare.

Një regjistrim gjithpërfshirës i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, do të sigurojë bazën e të dhënave zyrtare shumë të çmuara, shumë të domosdoshme si për punën e banesave po ashtu edhe për përkatësitë e popullatës, sipas gjinisë, moshës, etnisë dhe rajonit. Regjistrimi do të pasqyrojë realisht pos numrit të banorëve dhe gjendjen e tyre sociale, materiale, strukturën e saj, numrin e shkollarëve, të të punësuarve, të të papunësuarve, të pensionistëve – pra do të ishte një statistikë gjithpërfshirëse sipas kategorive dhe shtresimeve të popullsisë apo, siç e quajnë sociologët – sipas stratifikimeve sociale.

Regjistrimi do të sigurojë edhe shënimet zyrtare edhe për përqindjet e popullatës sipas përkatësive etnike dhe nuk do të lënte hapësirë për interpretime subjektive, për hamendsime, për spekulime, për manipulime politike apo mediale, me numra apo për keqpërdorime të këtyre shënimeve.

Regjistrimi i popullsisë së Kosovës do t'i evidentojë saktësisht të dhënat për potencialin tonë kryesor: resursin dhe parakushtin themelor zhvillimor – faktorin njeri, sidomos moshën aktive, meqë te ne në Kosovë, më shumë se kudo në Evropë, dominon struktura e të rinjve.

Shënimet e mbledhura nga një regjistrim kompleks do të shërbenin pastaj si bazë e domosdoshme në përcaktimin e politikave adekuate zhvillimore në sektore dhe në veprimtari të veçanta. Në bazë të të dhënave të tilla do të përcaktoheshin politikat dhe hapat konkret, politikat emergjente, intervenuese afatmesme dhe ato afatgjate, për të nxitur dhe përkrahur procese, rrjedha, sektore apo kategori të caktuara, varësisht nga politikat, nevojat dhe interesat e popullatës së Kosovës gjithpërfshirës.

Edhe në planin e regjistrimit të ekonomive familjare, do të siguroheshin shënime të domosdoshme për të pasqyruar saktësisht gjendjen sociale të popullatës, numrin e të punësuarve, sidomos të personave të papunë, gjendjen reale sociale familjare dhe burimet e jetesës. Në veçanti do të duhej siguruar pjesëmarrjen e plotë në regjistrimin e kosovarëve me punë dhe banim të përkohshëm në vendet perëndimore dhe përgjithësisht në botën e jashtme. Siç dihet, numri i tyre është shumë i madh, syzozohet me të drejtë me qindramijëra.

Në këtë aspekt duhet një bashkëpunim i institucioneve kosovare dhe i medias për sensibilizimin e diasporës që të marrë pjesë sa më masovikisht në këtë regjistrim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Naim Maloku, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

NAIM MALOKU:

I nderuari zoti kryetar, i nderuar zoti ministër, të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës të çmoj lartë rëndësinë e sjelljes dhe të miratimit të këtij ligji për Kosovën. Dihet që në njëqindvjetëshin e kaluar është manipuluar dhe kryesisht janë keqpërdorur të dhënat për popullsinë e Kosovës, janë keqpërdorur për qëllime të ndryshme politike dhe kryesisht në kurriz të popullatës shqiptare. Është manipuluar edhe me përkatësinë etnike, edhe me përkatësinë fetare, edhe me përkatësitë tjera, do të thotë gjinore e tjera.

Ligji është shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës sepse, në bazë të të dhënave që mirren me regjistrimin e popullsisë, bëhet edhe planifikimi i zhvillimit ekonomik të Kosovës, planifikimi hapësiror i Kosovës, Ministria e Arsimit nxjerr planin për zhvillimin e arsimit, pra në të gjitha sferat dhe lëmitë e shoqërisë bazë për krijimin dhe formimin e planeve dhe për zhvillimin e të gjitha sektoreve janë të dhënat që dalin me regjistrimin e popullsisë.

Mendojmë se më në fund ka ardhur koha dhe momenti kur duhet të dijmë se sa banorë jetojnë në Kosovë, duke përfshirë këtu edhe përqindjen e popullsisë etnike, fetare e tjera, e tjera.

Jemi të mendimit se gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji do të jemi të nënshtuar presioneve të ndryshme që të aprovohen nene që në mënyrë selektive do të bëjnë regjistrimin e popullsisë që përkohësisht jeton jashtë Kosovës. Dua t'ua tërheq vërejtjen deputetëve që të përgatitemi në ushtrimin e këtyre presioneve të kësaj natyre dhe të mos na ndodhë që edhe këtu të bëhet sikur në rregulloret për zgjedhjet kur, në mënyrë selektive, është përfshirë një përqindje apo një pjesë e banorëve që përkohësisht jetojnë jashtë Kosovës të nacionalitetit serb, ndërsa shqiptarët nuk janë përfshirë.

Ne përkrahim edhe propozimin e zotit Hamiti që qytetarët e Kosovës, që jetojnë përkohësisht jashtë Kosovës, të përfshihen të gjithë në regjistrimin e popullsisë.

Në parim përkrahim aprovimin e këtij ligji dhe ju ftojme që të votoni për të. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ramadan Kelmendi. Le të bëhet gati Rrustem Ibishi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra,

Vërtet, edhe unë përkrah miratimin e këtij ligji. Megjithatë, do t'i them disa vërejtje dhe konstatime të përgjithshme.

Një ndër ligjet që avancon e dhe pozitën e shtetësisë së Kosovës, është e dhe ky Propozimligj, i cili do të bëjë të mundur regjistrimin e popullsisë, ekonomisë

familjare dhe banesore në Kosovë. Ky ligj do të jetë i pari që do ta ketë Kosova, me të cilin do të mbyllet një kapitull e regjistrimit të popullatës sipas interesave të caktuara politike të kohërave të shkuara. Megjithatë, mendoj se para të fillojë zbatimi i këtij ligji, i cili ka rëndësinë dhe peshën e vet, duhet patjetër të kemi të miratuar ligjin mbi emërtimin e vendbanimeve në Kosovë, ngase pa këtë vërtetë emërtimet do të shkaktojnë probleme në regjistrim, dhe ligjin mbi pronën dhe banesat.

Me këtë ligj do të arrihet të kemi të dhënat e dëshiruara statistikore, me të cilat do të sqarohen shumë probleme të paraqitura jo drejt që nga regjistrimet e mëparshme, duke filluar në veçanti nga ai i vitit 1981 kur Serbia përpunonte të dhënat statistikore në mënyrë kabinetike dhe politike në kundërshtim me metodat demografike të njohura botërore dhe bashkëkohore dhe duke ndërruar realitetin.

Megjithatë, me këtë Propozimligj patjetër duhet të arrihen këto qëllime: struktura demografike e popullsisë mbi bazën nacionale, gjinore dhe grupmoshave; karakteristikat socio-ekonomike të popullsisë për të cilën vërtetë kemi nevojë të madhe; struktura e vendbanimeve dhe tipet e tyre; shpërndarja hapësinore gjeografike e popullsisë në Kosovë.

Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomisë familjare do të qetë në shesh regjistrimet e entit statistikor të Serbisë të vitit 1991 si regjistrime specifike që i shërbyen, thash më parë, një politike të një regjimi të caktuar, duke bërë përpjekje për ta ndërruar strukturën e popullatës në Kosovë dhe për t'i paraqitur qëllimet veç tanimë që janë të njohura. Megjithatë, në këtë fazë të aplikimit të këtij ligji do të kemi pengesa nëse nuk arrihet që drejtoritë kadastrale komunale dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës nuk do t'i kenë dokumentacionet e nevojshme për regjistrimin pasi që shumë dokumente të tilla nuk gjenden në duart e tyre, është grabitur dhe është në mungesë.

Me aprovimin e këtij ligji dhe zbatimin e tij, do të zgjidhen këto probleme: cila është struktura e vërtetë e popullsisë në Kosovë; sa është Kosova multietnike në raport me shtetet fqinj; sa është shkalla e papunësisë dhe gjendja e shkajshmërisë sociale në Kosovë; cilat janë grupmoshat dominuese në popullatën e Kosovës dhe do të mundësohet një analizë hulumtuese shkencore lidhur në tërësi me demografinë e popullsisë së Kosovës.

Para se të fillojë regjistrimi i banesave, duhet sqaruar raportin në mes bartësit të vërtetë të së drejtës banesore dhe shfrytëzuesve të banesave, kur dihet se që nga viti 1990 një numër i madh i shqiptarëve, e ai është 158.000, është dëbuar nga puna dhe me këtë ka humbur të drejtën banesore, siç është quajtur.

Vlerësoj, para që të vjen deri te aplikimi i ligjit, duhet bërë edhe aftësimin paraprak të komisioneve dhe në veçanti duhet t'i kemi të njohura dy çështje: me këtë regjistrim duhet të arrijmë të bëhet regjistrimi i popullatës së përhershme në Kosovë dhe popullatës së përgjithshme, që janë dy nocione demografike e që sqartësojnë numrin e popullsisë në Kosovë.

Do të kisha thënë, në nenin 1 nën d) Kushtet e banimit të popullsisë, duhet të plotësohet edhe me, “jo kushtet e banimit”, por “kushtet e strehimit” dhe në veçanti diskutues është neni 3, me çka pajtohem me të gjithë parafolësit dhe me profesorin kryetarin e Grupit Parlamentar – me popullatë rezidente jo, që e shpjegoi.

Unë do ta shtoj edhe këtë: Duhet të nënkuptojmë popullatën e përbërë nga individët “të cilët në ditën”..., nuk ka “ditë të evidentimit”, por “në ditën e regjistrimit”, dhe me këtë duhet përfshirë e tërë popullata jashtë dhe brenda. Pra, regjistrimi duhet të ketë si bazë të regjistrimit të përhershëm të popullatës së Kosovës, sepse një numër i madh i qytetarëve të Kosovës jetojnë jashtë Kosovës me shtetësi e pa shtetësi dhe me dy shtetësi dhe ata duhet të evidentohen si popullatë.

2. Duhet t'i dijmë shkaqet e migrimit të kësaj popullate, në cilat vende shtrihen dhe nga cilat vite janë. Kemi dëshmi se shtetet rreth nesh dhe shtetet demokratike në botë bëjnë regjistrimin e popullatës me ligjet e tyre – që nuk jeton në momentin e regjistrimit në shtet, andaj këtë të drejtë edhe ne duhet ta shfrytëzojmë.

Kush mund ta bënte këtë regjistrim? Shoqatat e ndryshme, klubet e ndryshme, format e komisioneve dhe përmes dërgesave postale patjetër duhet dhënë mundësi qytetarëve tanë që ta realizojnë të drejtën e tyre qytetare dhe të shprehin përkatësinë e shtetësisë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Rrustem Ibishi, le të bëhet gati Mahir Jaghillar.

RUSTEMI IBIŠI:

Gospodine predsedniče, gospodo poslanici,

Članovi Grupe – ostale zajednice ponuđeni Nacrt zakona smatraju veoma šturim i vrlo neprecizno definiše materiju. Pri svakom popisu stanovništva, bar je takva praksa u svetu, nužno je da se odredi koje će stanovništvo smatrati stanovništvom određenog naselja ili regije. Postoje dve kategorije pojmova ukupnog stanovništva:

stalno stanovništvo, prva kategorija; druga: prisutno stanovništvo. Stalnim stanovništvom - rezidencijalnim, termin pogrešno upotrebljen u prevodu, jednog područja smatraju se sva ona lica koja su na tom području imala mesto stalnog boravka, bez obzira na to jesu li u momentu popisa prisutna ili ne.

U Nacrtu zakona, član 3. termin "rezidentno" je pogrešno definisan. Zatim, druga kategorija, tojest prisutno stanovništvo. Pod prisutnim stanovništvom na jednom području smatraju se sva ona lica koja su u kritičnom momentu prisutna na tom području, bez obzira na to da li imaju stalni boravak ili ne.

Danas, širom sveta, popisi provode prema koncepciji stalnog stanovništva. Prema toj koncepciji, ponoviću - koncepciji stalnog stanovništva, ukupno stanovništvo jednog područja dobijamo iz tri grupe. Prvu grupu čini stalno prisutno stanovništvo; drugu grupu čini privremeno odsutno stanovništvo; treću grupu čini privremeno prisutno stanovništvo.

Da pojasnimo malo ove grupacije. Stalno prisutno stanovništvo čine lica koja su u času popisa prisutna na području u kome imaju stambeni boravak. Privremeno odsutno stanovništvo čine lica koja su u momentu popisa imala stalni boravak ali su slučajno ili iz određenih razloga odustala. Privremeno prisutna lica čine lica koja su slučajno zatekla u tom mestu a mesto boravka imaju izvan područja popisa.

(Vërejtja e kryesuesit: Rrustem, të lutem nuk ke nxënës para veti e as ligjerata të studentëve, ju lutem.)

Po rečenom, prema objašnjenom, formula za to bi izgledala ovako: ovo je svetski standard, a molim gospodu koja ne veruje u ovo, neka proveri.

Vratiću se Nacrtu. Ovaj Nacrt, prvo, nijednim svojim članom ne precizira ni na koji način kako će se popisati privremeno odsutna lica, a njih ima mnogo iz redova svih zajednica, niti kako će se popisati nasilno oduzete stambene jedinice i poslovni prostor. Da li će ovaj Parlament može da garantuje da će se nasilno oduzeta imovina vratiti do početka popisa. Sigurno da ne može.

Ako se metodološka uputstva za popis sačine prema Nacrtu ovog zakona, za posledice, gospodo, imaćemo sledeće: popisom stanovništva dobićemo netačne podatke o demografskoj strukturi i socio-ekonomskim karakteristikama stanovništva; dobićemo pogrešne podatke o sveukupnom broju stanovništva i njegovoj teritorijalnoj raspoređenosti na Kosovu, jer će, prema navedenim kriterijumima, veliki broj stanovništva, ostati nepopisan.

Obzirom da član 25. ovoga Nacrta precizira donošenje podzakonskih akata u vezi sa članovima sve od 11. do 21. mislim da je jedan tu u tom mnoštvu izuzet, jedan od njih se odnosi i na formiranje opštinskih popisnih komisija.

Ovog momenta, pripadnici grupacije ostale zajednice apeluju na Vladu da u tom zakonskom podaktu jasno precizira sastav članova komisija koji bi trebalo da odražava i nacionalnu i jezičku strukturu u mešovitim sredinama odnosno opštinama.

Ukoliko ove, i primedbe ostalih poslanika budu prihvaćene, članovi Poslaničke grupe - ostale zajednice, glasaće za ovaj Nacrt zakona. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit Mahir Jaghillar dhe Tomë Hajdari, i fundit

MAHIR YAĞCILAR:

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar. Gerçekten bu kanun Kosova için çok önemlidir. Biz de inanıyoruz ki ilk defa Kosovada demokratik bir biçimde vatandaşlar sayımları yapılacaktır. 1991, 1981, 1971, 1961 ve 1951 de hepsi bunlar gerçekten yapıldı ama biz hepimiz farkındayız bir komünist dönemi idi ve herkes kendi açısından kendisini ifade edemiyordu. Bu sayımların demokratik bir ortamda olacağına inanıyoruz ve biz de bu konuda Kosova Türk toplumu olarak desteğimizi vereceğiz. Sayın Sabri Hamitinin dediği gibi, üç nokta, A noktasında rezident terimi bizim için de pek ayan değil ve bir yıllık yalnız rezident, çünkü tüm diğer toplumlardan da doğal olarak Kosova Türkleri de son on yıldır çeşitli migrasyon sebeplerinden dolayı Kosovadan göçetmişlerdir. Ve bunun bu terimin daha iyi açıklanması önemli olurdu. Kosova Türk toplumu için daha iki önemli konu var bu konularda. Birincisi, komisyonların seçilmesinde Türklerin de Türklerin yaşadığı belediyelerde yer almaları ve ikincisi kayıtları zaman formların Türkçe olması. Bu Kosova Türk toplumu için çok önemlidir, gerçekten belki bu kanunda yazılmaz ama yönetmeliklerde yer alması bizim için çok çok önemlidir. Teşekkür ederim.

KRYESEUSI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë Mahir. Tomë Hajdari.

TOMË HAJDARI:

Ju falemnderit zoti kryetar,

Unë mendoj se në këtë Projektligj, kapitull të veçantë duhet të ketë edhe regjistrimi në sferën agrare të Kosovës, sepse, sipas informatave që kemi dhe shënimeve zyrtare nga ishsistemi, regjistrimi i fundit është bërë më 1961 dhe m'u për atë, me këtë ligj, kisha lutur zotrin ministër dhe stafin e tij që të ketë një konsideratë të veçantë në këtë sferë kur dihet se një numër i konsiderueshëm, për mos me thënë 60% e popullatës janë nga zona rurale dhe merren me bujqësi në të gjitha sferat, duke mos aluduar edhe në atë se për fat të keq, ende nuk është dalë me një informatë zyrtare me dëmet e shkaktuara që nga viti 1989 dhe posaçërisht gjatë luftës në agrar. Andaj, kisha dëshiruar që për të ndalë trendin e informatave të pabazuara të cilat po qarkullojnë këto ditë, regjistrimi i mirëfillt i ekonomisë familjare në sferën e bujqësisë, kishte për të zënë një kapitull të veçantë, duke u isur nga tokat bujqësore, në pylltari, në hlektori, në vreshtari, pemtari dhe mekanizim bujqësor. Andaj, kisha dëshiruar dhe ju lus që të keni një konsideratë lidhur me këtë kapitull. Ju falemnderit.,

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Tomë të falemnderit. Dëgjuam të gjithë të paraqitur për debat në parim.

Ju ftoj të deklarohe mi.

Kush është për aprovimin në parim të ligjit të propozuar.
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 11 kundër.

Kush abstenon? Nuk ka abstenime.

Konstatohet se Ligji në parim është aprovuar, me 11 vota kundër.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For:Shumica – Veçina – Majority...
 - Kundër – Protiv – Against11
 - Abstenuan – Uzdržanih – Abstained 00
-

Tani do të kemi një pauzë dhe ajo do të zgjasë deri 12,15. Ju falemnderit.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

PAS PAUZËS, SEANCËN E KRYESOI BASHKËKRYESUESI OLIVER IVANOVIQ, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Nastavljam o sa radom. U sali je prisutno 77 poslanika i imamo kvorum.

Na redu je tačka 5. dnevnog reda: Razmatranje predloga Parlamentarne grupe Koalicije "Povratak" o imenovanju nekoliko članova u komisijama Skupštine.

Ovaj predlog je već bio na odborima i bio je na Predsedništvu i Predsedništvo se oglasilo oko toga.

Da li ima potrebe da otvaramo raspravu o tome? Izvolite.

FLORA BROVINA:

Kam vërejtje në propozimin që nënkryetar i parë i Komisionit për personat e rrëmbyer e të humbur pa gjurmë gjatë luftës është nga Koalicioni "Kthimi". Në të vërtetë, dokumentin duhet kontrolluar në administratë sepse nënkryetar i parë është nga Lidhja Demokratike dhe deri tani ka qenë zonja Sanije Alijaj dhe besoj se kështu do të është. Nuk di pse ka ndodhur ky gabim?!

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Da li se još ko javlja za reč?

Da li može Služba da vam da objašnjenja?

Primedba Službe je: da je netačno interpretirano. Znači da je kandidat Koalicije «Povratak» po predviđenoj šemi je, mi ćemo to još jedanput proveriti, drugi zamenik. U redu, mislim da je štamparska greška.

Da li još neko javlja za reč? Ne.

Možemo li da glasamo o ovome?

Ko je za predlog? Hvala.

Ima li protiv?

Ima li uzdržanih? Tri glasa uzdržanih.

Sa tri uzdržana glasa usvojili smo ovaj predlog.

Tačka šest: Razmatranje preporuke Sudskog i tužilačkog veća o imenovanju sudije i tužilaca.

To smo razmatrali na prošoj sednici. Bilo je na raspravi i na Predsedništvu. Komisija za zakonodavna i pravosudna pitanja je izrazila svoje neslaganje. Ja predlažem da predsednik Komisije da dodatna obrazloženja.

ARSIM BAJRAMI:

Të nderuar kolegë, në mbledhjen e kaluar ne kemi bërë disa emërime të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe, ju kujtohet mirë, kemi vendosur për kandidatin, për të cilin sot po diskutojmë, të kërkohej të dhëna shtesë rreth aktivitetit të tij profesional në periudhën pas viteve të 90-ta. Ne kemi dërguar një letër Komisionit prokurorial dhe gjyqësor ku kemi kërkuar të na prezentojë të dhënat për aktivitetin e tij në periudhën e cekur.

Në përgjigjen që kemi marrë nga ky Komision, është konstatuar se i njëjti ka punuar në detyrat me përgjegjësi në Shtëpinë Ndëshkuese-Korrektuese në Smrekonicë dhe për shkak të punëve që ka pasur ai ka pasur edhe stazh të beneficuar.

Duke u nsiur nga ky fakt, Komisioni ka propozuar që Kuvendi mos të bëjë zgjedhjen e tij, pra ka refuzuar emërimin e tij dhe propozon që Kuvendi ta miratojë këtë propozim të Komisionit dhe të kërkojë që në propozimet e ardhshme për

gjqytarë që do të pasojnë - Komisioni prokurorial të prezentojë të dhënat e plota për shkak se në këtë rast ne nuk kemi patur të dhënat e plota për natyrën e punëve që kandidati në fjalë ka punuar.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Hvala, gospodine Bajrami.

Da li se još neko javlja za reč? Ima reč Hidajet Hiseni.

HYDAJET HYSENI:

I nderuar kryesues, të nderuar kolegë deputetë,

Më duhet edhe një herë të përsëris vërejtjet që kam theksuar edhe më parë në këtë foltore lidhur me procedurën, por edhe me kërkesat që po i bëhen Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial. Vërejtja i adresohet deridiku edhe Komisionit, i cili, edhe përkundër i insistimeve edhe në këtë sallë, a snjëherë nuk ka kërkuar informacion komplet për kandidatët, duke përfshirë këtu edhe faktet: – a janë apo nuk janë banorë të Kosovës; cila është datëlindja e tyre. Ne kemi përkrahur ose kemi refuzuar kandidatë për të cilët nuk dijme edhe çfarë moshe kanë, që mendoj, është non sens. Prandaj, mendoj se kjo duhet të jetë praktikë edhe vërejtje për të ardhmen.

Dhe, vërejtja ime e dytë, ka të bëjë me: – çka pastaj? Ne na kanë ndodhur që edhe këtu kemi bërë vërejtje dhe nuk i kemi dhënë..., pëlqimin për ndonjë nga kandidatët e propozuar. Mirëpo, më vonë, jemi informuar se ata, megjithatë, janë bërë gjykatës. Dhe, shtrohet pyetja: ku po shkojmë kështu, dhe çka mendon, ta zëmë Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial nëse mendon që të imponojë gjyqtarë dhe prokurorë që nuk kanë pëlqimin edhe të përfaqësuesve të zgjedhur të Kosovës, do të thotë edhe të elektoratit të tyre dhe çka nëse shkojmë ne me këtë logjikë të konfrontimit. Ne kemi pasur një përvojë shumë të hidhur dhe kemi edhe një përvojë me të cilën besoj se nuk do të dëshironim ta përdornim në situata të reja që po na imponohen. Ju falemnderit.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Zahvaljujem se gospodinu Hiseniju.

Da li se još ko javlja za reč?

MEHDI BARDHI:

E nderuar Kryesi, të nderuar ministra dhe deputetë,

Unë desha të flas nja dy-tri fjalë. Ne po bisedojmë sot për gjyqtarët dhe në realitet unë nuk di se, ndoshta ju e dini, atë Këshill Gjyqtar kush e ka formuar, si është formuar, nga kush; hëëë, dhe nëse dihet, atëherë ne po i aprovojmë gjërat, për shembull, të cilat, si me thënë, veç na diktohen dhe atëherë i aprovojmë ashtu si janë. Përndryshe, unë nuk do ta ngris dorën fare për këta gjyqtarë të cilët, konsiderojmë dhe konsiderojnë e gjithë popullata, se ata kanë qenë një vegël e zgjatur apo në duar të zgjatura të ish pushtetit serb, të cilët, në bazë të atyre ligjeve diskriminuese, na kanë dënuar, na kanë masakruar dhe na i ka bërë të gjitha. Ju falemnderit.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Hvala. Za reč se javio Dragiša Krstović.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo poslanici,

Za nas, iz Koalicije «Povratak», kriteriji - ko je gde ranije radio, nije prihvatljiv. Biće prihvatljiv jedan drugi kriterij. Ko je kako radio i ko je koliko poštovao ili kršio ljudska prava i prava manjinskih zajednica. Mi ćemo uvek o tome voditi računa. A ko je gde radio, da li je ko radio u ovom kaznenom popravnom domu kao neki evidentičar ili u onom kao neki koji je vodio neke registre, to zaista neće biti nešto što će odlučivati našu volju da... odnosno naš stav da za nekoga glasamo ili ne glasamo, ali to ko je poštovao ljudska prava a radio u nekom kaznenom popravnom domu, to je sasvim jedna druga priča. Prema tome, mislim da ovom prilikom zaista imamo sasvim drugačije stavove o tome i stav Koalicije «Povratak» je taj. Znači, nećemo se baviti time ko je gde radio u proteklom periodu a ako ima zaista valjanih dokaza o tome da je neko kršio ljudska prava u svom radu i da to može da se dokaže, bićemo zaista protiv da se takvi ljudi biraju za sudije i tužioce. Hvala.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Hvala. Pretpostavljam da nema više diskutanata. Ja moram da vas obavestim da je lista već usvojena. Znači, ostao je samo jedan ovaj kandidat, koji je u izvesnom smislu bio diskutabilan sa aspekta odbora koji je nadležan za tako nešto. To spada u rezervisana prava i on je tražio mišljenje naše. Znači Specijalni predstavnik može odlučiti prema nahodanju.

Ja stavljam predlog Komisije na glasanje.

Ko je za? Molim vas da se izbroju...

Izvinjavam se, predlog Parlamentarne komisije...

Dobro, mislim da je većina. Hvala.

Ko je protiv? Jedan. Hvala.

Ima li uzdržanih? Neka se prebroje uzdržani. 20 uzdržanih. Nema protiv.

Znači, od 77 prisutnih - usvojen je predlog i prosledićemo tako pismo Kancelariji Specijalnog predstavnika.

Izvinjavam se. Izvinjavam se, protiv je jedan, znači.

Votimi – Glasanje – Voted:

- Për – Za – For:.....56...
 - Kundër – Protiv – Against.....01...
 - Abstenuan – Uzdržanih – Abastaned.....20...
-

Prelazimo na sledeću tačku dnevnog reda: **Pitanja Komisiji za prigovore i žalbe.**

Postavljeno je pitanje za ministra gospodina Jakupa Krasniqija od strane dva poslanika Alush Gashi i Ismajl Kurteshi, koji su postavili usmena pitanja.

Da li je ministar spreman da odgovara danas? Hvala.

JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë, kam katër pyetje nga dy deputetë. Deputeti Alush Gashi ka bërë një pyetje për dokumentat civil. Deputeti Ismajl Kurtëshi ka tre pyetje dhe gjithsej janë katër pyetje.

Unë do të përpiqem t'i them sa më shkurt përgjigjet e mia, meqenëse për ndonjë pyetje do të jem ndoshta paksa më i gjatë.

Pyetja e deputetit Alush Gashi është: Çka është bërë në drejtim të pajisjes së qytetarëve tanë me qëndrim të përkohshëm në botën e jashtme me dokumente të udhëtimit.

Është e ditur se shumë qytetarë nga Kosova që jetojnë dhe punojnë në shtetet e Evropës Perëndimore por edhe më gjerë kanë vështirësi për të dëshmuar identitetin dhe prejardhjen e tyre, sepse nuk kanë mundësi të udhëtojnë në Kosovë për t'u pajisur me dokumentet e identitetit dhe të udhëtimit, të cilat i lëshon administrata e UNMIK-ut, në mungesë të dokumentave të udhëtimit, sepse atyre, me të cilët kanë qenë të pajisur, iu ka kaluar afati.

Çështja e dhënies së dokumenteve të identifikimit dhe atyre të udhëtimit edhe më tej ndodhet në suazat e kompetencave të rezervuara dhe në këtë plan Ministria e Shërbimeve Publike nuk ka mundësi, tash për tash, të bëjë asgjë më tepër.

Sa për ilustrim po përmendim kapitullin 8, pika 8.1 të Kornizës kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme në Kosovë, Rregullorja 2001/9, ku edhe më tej disa kompetenca dhe përgjegjësi janë të rezervuara për organin ekzekutiv të PSSP. Këto kompetenca përfshijnë: kontrollin dhe pushtetin mbi regjistrin civil, të bazës së të dhënave, i cili mirëmbahet në bashkpunim me institucionet e përkohshme të qeverisjes, pra në Ministrinë e Shërbimeve Publike.

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, neni 2.2, pika ë), shtojca 9, nën 7 – Ministria e Shërbimeve Publike ndihmon në administrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të regjistrimit qendror civil dhe bazës së të dhënave...Edhe pse, tashpërtash, Ministria e Shërbimeve Publike është vetëm në suazat e ndihmës, po bëhen përpjekje që në periudhën e ardhshme dhe këto përgjegjësi gradualisht të kalojnë në kompetencat e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe vetëm atëherë çështja e pajisjes së qytetarëve tanë me dokumente kosovare të udhëtimit do të zgjidhet më shpejt, ndoshta edhe më drejt.

Duhet përmendur faktin se një numër i qytetarëve tanë që kishin dokumente të ish jugosllavisë, iu kanë kaluar afatet e përdorimit. Këta qytetarë, janë të interesuar të pajisen me dokumenta zyrtare të Kosovës sa më parë dhe nuk dëshirojnë të kenë dokumenta tjerë. Shi për këtë, ne angazhohemi për një zgjidhje të pranuar dhe efikase që do t'ua lehtësonte qytetarëve tanë sigurimin e dokumentave të udhëtimit por jo vetëm të tyre, andaj kemi kërkuar nga UNMIK-u që në bashkëpunim me institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, të hapen zyrat e ndihmës ndërlidhëse në ato vende ku është koncentrimi më i madh i qytetarëve nga Kosova, si bie fjala, në Gjermani dhe Zvicër, ku do të mund të pajiseshin me dokumenta edhe qytetarët tjerë nga Kosova që jetojnë në shtetet përreth.

Besojmë se së shpejti do të ndërmerren masa të duhura në këtë drejtim.

Edhe unë personalisht, nuk jam i kënaqur me rrjedhat e bartjes së kompetencave që kanë të bëjnë me sigurimin e dokumentave në përgjithësi dhe të dokumentave të udhëtimit në veçanti. Pasi këto ditë isha në Zvicër dhe në kontakt me qytetarët u bënë edhe disa ankesa të reja. Në disa kantone të Zvicrës, qytetarët, e dhe pse e kanë dokumentin e udhëtimit të lëshuar nga UNMIK-u. Në lejet e qëndrimit apo të punës në Zvicër në vend të shtetësisë shënohet unioni Serbi-Mal i Zi. Po ceku, jo në të gjitha kantonet, por në ndonjë kanton.

Gjithashtu, kam kërkesa me anë të telefonave nga qytetarët nga Gjermania, të cilët në Republikën e Bavarisë, në Gjermaninë Federale, qytetarëve tanë që punojnë atje, nuk u pranohen dokumentat e udhëtimit, por kur është çështja e shtetësisë dhe kërkojnë që me çdo kusht të shkojnë në ambasadat dhe në konsulatat e unionit Serbi-Mali i Zi. Dhe, mendoj se kjo është një padrejtësi tjetër që iu bëhet qytetarëve tanë, do të thotë është një shkelje e të drejtave më elementare të njerëzve. Kur kësaj i shtojmë se në këto konsulata, në të shumtën e rasteve, kërkojnë edhe mito, mendoj se disa vende, edhe në emër të demokracisë, janë duke lejuar ose duke legjitimuar korrupsionin.

Deputeti Ismajl Kurteshi ka bërë tri pyetje. Pyetja e parë është: sa rrespektohet ligji për shërbyesit civil dhe si funksionon pushteti lokal në territorin e Kosovës?

Duke u bazuar në dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2001/9, të Kornizës kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë, Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 (më falni, e para ishte 9) mbi degën e ekzekutivit, Ministria e Shërbimeve Publike ka bërë të gjitha përgatitjet që Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbyesit civil të Kosovës dhe Urdhëresën administrative 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi shërbimet civile të Kosovës t'ua dërgojë të gjitha ministrive dhe komunave të Kosovës.

Me qëllim të funksionimit sa më efikas të ligjit, janë mbajtur një varg seminaresh, trajnimesh për kategori të ndryshme të shërbyesve civil të Kosovës me qëllim të zbatimit në praktikë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbimet civile të Kosovës dhe Urdhëresës administrative 2003/2. Deri më tash është punuar në 11 udhëzime administrative, prej tyre 6 procedura të rekrutimit, të kontratave të punës, të disiplinës, të ankesave dhe të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Kurse pesë procedurat tjera, si bie fjala: procedurat e detyrave të punës, vlerësimit të punës, orëve të punës dhe vijimit të punës, e pushimeve, procedurat e dosjeve personale janë në procedurë të miratimit. Ndërsa, Rregullorja 2001/36, është duke u zbatuar në shërbimet civile të Kosovës veçanërisht në administratën e Qeverisë së Kosovës dhe në atë të ministrive. Vendet e punës të nëpunësve civil publikohen në mjetet e informimit, emërohet paneli dhe intervista dhe zgjedhjet e kandidatëve. Në rastet kur nuk zbatohet Ligji i shërbimit civil të Kosovës, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve, Ministria e Shërbimeve Publike merr vendime të caktuara me qëllim të zbatimit të të drejtave të Ligjit të shërbimit civil të Kosovës.

Këtu duhet të them se jo në çdo rast, por në shumë raste, kemi shkelje të Ligjit ose të Rregullores mbi shërbimin civil të Kosovës dhe Urdhëresës administrative mbi zbatimin e rregullores për shërbyesit civil në Kosovë. Dhe, kjo shkelje kryesisht bëhet në pushtetin lokal por në disa raste të veçanta edhe në ministri të veçanta. Dhe është një praktikë e keqe sepse njëmend kemi pakënaqësi me rregulloren apo ligjin në fuqi, por derisa nuk kemi ligj tjetër, mendoj se është obligim i udhëheqësve që t'i respektojnë këto ligje.

Pjesës tjetër – të funksionimit të pushtetit lokal. Pushteti lokal në Kosovë funksionon në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 45/2000 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës. Kjo rregullore në shumë segmente të saja është e tejkaluar dhe nga kjo arsye Ministria e Shërbimeve Publike ka filluar inisiativën për hartimin e ligjit të ri mbi pushtetin lokal në Kosovë. Rregullorja aktuale në bazë të së cilës funksionon pushteti lokal, nuk ka krijuar mekanizmat sistemor mbrojtës për ruajtjen e autonomisë së komunave, kështu që kemi ndërhyrje të shumta nga niveli qendror, që kufizojnë autorizimin e komunave, si dhe transferimin e përgjegjësisive nga stafi i UNMIK-ut, te vendorët nuk ka shkuar sipas dinamikës së planifikuar.

Shumë rregullore të UNMIK-ut janë në kundërshtim me Rregulloren 2000/45, si për shembull Rregullorja 2000/49, me të cilat komunave iu mohohet e drejta e menaxhimit të shërbimeve publike komunale.

Pas zgjedhjeve lokale, të mbajtura në nëntor të vitit 2002, në disa komuna ka pengesa serioze në konstituimin e stafit ekzekutiv. Edhe pse nga ana e DAL-it, si pjesë e Ministrisë së Shërbimeve Publike, me kohë është nxjerr udhëzimi

administrativ mbi implementimin e zgjedhjeve. Shumica e komunave nuk kanë rrespektuar atë. Në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 36/2001 janë qasur zgjedhjes së stafit të lartë ekzekutiv, kryeshefit dhe drejtorëve të drejtorive komunale pa rrespektuar procedurën e paraparë me Rregulloren 2000/45 dhe në kundërshtim me Rregulloren 20001/36. Motivi për veprime të tilla ka qenë i bazuar në baza partiake dhe politike. Edhe me stafin me të ulët civil ka pasur rekrutime në baza partiake, kështu që përcaktimi i Rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës ndarja e stafit publik nga ai civil në masë të madhe është zbehur.

Me një fjalë, pushteti lokal, në parim funksionon në tërë territorin e Kosovës, kurse pjesërisht funksionon edhe në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në enklavat serbe.

Duhet theksuar se pushteti lokal nëpër komuna funksionon me vështirësi dhe me telashe të theksuara, që disa u cekën më lartë.

Gjatë periudhës së shkuar ka ekzistuar një dallim në mes komunave që janë me shumicë shqiptare dhe atyre që janë me shumicë serbe, sidomos këto diferenca i kanë shkaktuar administratorët komunal. Unë po ceku vetëm një shembull. Në disa komuna administratorët komunal në të kaluarën kanë prishur vendimet e asambleve komunale, edhe pse ato asamble kanë punuar me rregullore të UNMIK-ut dhe me ligjet në fuqi, kurse nuk është asnjë rast i shfuqizimit të vendimeve të asambleve komunale në komunat me shumicë serbe, edhe pse ato komuna kanë funksionuar mbi baza të ligjeve të Serbisë dhe jo të rregulloreve të UNMIK-ut dhe administratorët komunal në ato komuna nuk kanë shfuqizuar asnjë vendim të asambleve.

Është edhe një pyetje tjetër: A lejohet mbajtja e dy vendeve të punës në realizimin e dy rrogave nga buxheti i konsoliduar i Kosovës siç po ndodhë me disa deputetë të cilët mbajnë poste të larta në institucionet e Kosovës.

Unë mund të përgjigjem vetëm në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të shërbimit civil të Kosovës. Në bazë të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës, nëpunësi civil duhet t'i përmbahet nga angazhimi i tyre në aktivitetin politik. Kurse, në bazë të pikës 11 të pjesës shtojcë të kësaj rregulloreje, që ka të bëjë me rregulloren e mirësjelljes në shërbimin civil, thuhet:

Nëpunësit civil nuk marrin pjesë në kurrfarë aktiviteti politik dhe publik që mund të rrezikojë ose që duket se mund të rrezikojë anësinë e tyre. Gjithashtu, edhe sipas nenit 28 pika 4 të urdhëresës administrative Nr. 2002/2 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 thuhet: Nëpunësit civil i zgjedhur për një post publik siç janë sekretarët e përhershëm, drejtorët e ekzekutivit dhe kryesuesit

e departamenteve, këtu hyjnë edhe kryeshefat e ekzekutivit duhet të japin dorëheqje me efekt nga data kur bëjnë betimin duke konfirmuar pranimin e postit të zgjedhur. Nëse nuk zgjedhet, nëpunësi civil do të lejohet t'i kthehet detyrave të tij në shërbimin civil brenda një jave nga dita kur rezultatet e zgjedhjeve deklarohen formalisht.

Në bazë të të dhënave të paraqitura më lartë, është shumë e qartë se deputetët e Kuvendit të Kosovës, po ceku – deputetët e Kuvendit të Kosovës, dhe delegatët e kuvendeve komunale, edhe në bazë të nenit 28 pika 1, 28 pika 2 dhe 28 pika 3 të Urdhëresës administrative nuk kanë të drejtë të mbajnë poste udhëheqëse në shërbimin civil të Kosovës. Bile, jo vetëm se nuk kanë të drejtë, por bëjnë edhe shkelje të detyrave të punës sepse në bazë të nenit 17 pika 1 të Urdhëresës administrative të sipërpërmendur, për shkak të angazhimeve në mbledhjet e Kuvendit dhe të komisioneve nuk plotësojnë orarin e punës prej 40 orësh që është e domosdoshme në javë. Pra, duhet ta dijmë, deputetët e Kuvendit të Kosovës, që mbajnë poste udhëheqëse në shërbimet civile nuk kanë të drejtë t'i mbajnë dy detyra. Njërën duhet ta lirojnë.

Mendoj se unë ceka rregulloret. Nëse ndokush mendon se nuk janë..., lexoni dhe shihni se unë kam të drejtë.

Cilat janë përgjegjësitë e Minsitrisë së Shërbimeve Publike mbi administratën gjyqësore, është pyetja tjetër.

Sipas kreut 5, paragrafi 5.3 nën b) të Kornizës kushtetuese, institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës ushtrojnë përgjegjësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave brenda strukturave ekzistuese të gjykatave. Kështu është në Kornizën kushtetuese. Në bazë të pjesës shtojcë 11, pika 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19, thuhet: kryen funksionin në lëmin e çështjeve gjyqësore edhe pse në bazë të akteve të sipërpërmendura nuk janë të definuara mirë përgjegjësitë në departamentin e administratës gjyqësore, janë bartë përgjegjësitë që kanë të bëjnë me administratën gjyqësore, këto përgjegjësi janë: Furnizimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e gjykatave dhe shërbimeve të prokurorisë; furnizimi i nevojave teknike dhe financiare; mbështetja në personelin dhe materialet burimore; trajnimet dhe aftësimi i gjykatësve të ri, dhe trajnimet tjera të personelit; provimet profesionale për gjykatës, prokurorë dhe avokatë; statistikat dhe informatat mbi sistemin gjyqësor. Përgjegjësitë e sipërpërmendura janë bartë tani, mirëpo buxheti është nën kompetencat e departamentit të drejtësisë pranë

UNMIK-ut, si dhe një numër i konsiderueshëm i këshilltarëve të UNMIK-ut të cilët edhe sa e kryeson këtë departament, nuk kanë bërë ndonjë lëvizje të kënaqshme, projektligje, rregullore e procedura që janë dashur t'i bëjnë nuk janë përgatitur. Mirëpo, derisa financat nuk kontrollohen dhe nga sekretari i përhershëm

i ministrisë nuk mund të caktohen njerëzit që do të kontrollojnë dhe do të nënshkruajnë çështjet buxhetore, konsideroj se ky departament fare pak janë të bartuara kompetencat nga UNMIK-u në administratën vendore gjegjësisht në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Dhe konsiderojmë se në Ministrinë e Shërbimeve Publike njëri nga departamentet që më së paku kanë bartur detyrat dhe përgjegjësitë që i lejon Korniza kushtetuese i lejojnë edhe rregulloret tjera, mendojmë që i është bërë një padrejtësi në këtë fakt Ministrisë së Shërbimeve Publike, gjegjësisht departamentit të administratës gjyqësore.

Po shpresojmë se me angazhimin dhe formimin e këshillit të bartjeve të kompetencave kjo çështje do të ndryshojë gjatë këtij viti. Ju falemnderit.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

~~Zahvaljujem se ministru Poslanici Gashi i Kurteshi su zadovoljni sa odgovorom?~~

Kurteshi ima pravo po Poslovniku o radu da postavi dopunsko pitanje.

ISMAJL KURTESHI:

Së pari falënderoj ministrin për përgjegjet në pyetjet, të cilat unë i kam bërë. Jam i kënaqur me përgjegjet dhe këto pyetje i kam bërë pasi që jetoj në njërin nga komunat e Kosovës dhe jam mirë i njoftuar se nëpër komunat tona shpesh ndodhë që të mos rrespektohen sa duhet procedurat e parapara me rregulloren për qeverisjen lokale, se shumë shpesh ndodh që tenderët të keqpërdoren dhe po ashtu besoj se ministri është i njoftuar dhe Ministria në përgjithësi se në disa enklava serbe veprojnë...

(Ndërhyrja e kryesuesit: Gospodine Kurteshi, nemate pravo na diskusiju. Imate samo dopunsko pitanje, ako nešto nije bilo dovoljno jasno izlaganje ministra).

...Elektroekonomia e Serbisë dhe posta e Serbisë se nëpër disa komuna ende nuk është kthyer asnjë pronë e uzurpuar, se ndërtime pa leje po vazhdojnë në të gjitha komuntat e Kosovës, prandaj besoj që Ministria juaj dhe institucionet tjera të Kosovës do të ndikojnë që këto dukuri negative të mënjanohen sa më parë. Ju falemnderit.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Ovo nije bila diskusija. Ja vas molim da se pridržavate Poslovnika. Imali ste pravo na dopunsko pitanje samo ukoliko ministar nije bio dovoljno jasan.

Smatram da je ova tačka završena.

Prelazimo na sledeću tačku... Izvolite. Nemate pravo za ovo. Ako imate pitanje, procedurom morate da dostavite pitanje najmanje pet radnih dana pre sednice na kojoj će biti odgovarano. Hvala. Izvolite.

Molim vas po ovom pitanju nemate pravo.

RAMADAN KELMENDI:

Kam të drejtë të pyes, sepse me datën 4. 03. 2003 kam paraqitur pyetje me shkrim dhe akoma s'kam marrë përgjigje. E dyta, më datën 15. 05. kam parashtruar katër pyetje dhe për to nuk është ardhë asgjë në rend dite. Shtroj pyetjen – pse ndodhë kjo dhe si deputet kam të drejtë ta bëj këtë.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Imate pravo da dobijate odgovor. Mislim da će vam pismeno biti odgovoreno zašto to nije stavljeno na dnevni red.

Sledeća tačka dnevnog reda je osma tačka: **Predlog dnevnog reda za sledeću Plenarnu sednicu 29. maja.**

U prilogu dobili ste predlog dnevnog reda. Randel Nojkić...

RANDEL NOJKIĆ:

Gospodine predsedavajući, dame i gospodo,

Predlažem da se drugo čitanje Zakona o putevima za sledeću sednicu odloži iz sledećeg razloga: Ja sam već rekao na početku da nisam bio u mogućnosti da dostavim amandmane, iako sam ispoštovao celokupnu proceduru. S obzirom da su usledile neke dodatne inicijative ja se nadam da ću ostvariti to pravo i da će mi

javiti da mogu blagovremeno da dostavim amandmane i tek nakon, pošto ti amandmani budu razmatrani na Funkcionalnoj komisiji, može da se stavi ova tačka na dnevnom redu, jer je Funkcionalna komisija juče zasedala, nije imala kvorum, nije donela nikakvu odluku i smatram da nisu ispunjeni uslovi da se ova tačka dnevnog reda nađe na narednoj sednici. Hvala.

KRYESUESI OLIVER IVANOVIĆ:

Hvala i vama. Da li neko od šefova poslaničkih grupa ima ozbiljnu primedbu?

Ako nema, smatram da ćemo ovu primedbu uzeti u obzir na sledećoj sednici Predsedništva i da vidimo koliko su opravdani ovi razlozi.

Smatram da je dnevni red usvojen i hvala vam na učešću.

Seanca përfundoi në orën 13,00.

RT/1-46